PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS
FEDERALE TË GJERMANISË

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I DYTË

ÇËSHTJA PULFER KUNDËR SHQIPËRISË

(Kërkesa nr. 31959/13)

VENDIM

STRASBURG
20 nëntor 2018

I FORMËS SË PRERË
20.2.2019

Ky vendim është bërë i formës së prerë, bazuar në nenin 44§2 të Konventës. Ai mund të bëhet objekt i rishikimit redaktues.

Në çështjen Pulfer kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Dytë), e mbledhur si një Dhomë, e përbërë nga:

Robert Spano, *kryetar*,
Julia Laffranque,
Ledi Bianku,
Paul Lemmens,
Jon Fridrik Kjølbro,
Stéphanie Mourou-Vikström,
Ivana Jelić, *gjyqtarë*,
dhe Hasan Bakırcı, *zëvendëssekretar i Seksionit*,
pasi diskutuan me dyer të mbyllura, më datë 16 tetor 2018,
shpall vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në po atë datë:

PROCEDURA

1. Çështja filloi me një kërkesë (nr. 31959/13) kundër Republikës së Shqipërisë, paraqitur në Gjykatë me datë 19 prill 2013, mbështetur në nenin 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ("Konventa"), nga një shtetase shqiptare, znj. Violeta Pulfer ("kërkuesja").

2. Kërkuesja u përfaqësua nga znj. A. Kuçani dhe z. G. Çela, avokatë të cilët ushtrojnë detyrën në Tiranë. Qeveria shqiptare ("Qeveria") u përfaqësua nga agjenti i saj, znj. A. Hicka nga Avokatura e Shtetit.

3. Kërkuesja, veçanërisht, pretendonte se pamundësia e autoriteteve për t'i mbrojtur jetën në mënyrë të shpejtë, shkelte nenet 2 dhe 6 të Konventës. Gjithashtu, ajo ankohej, mbështetur në nenin 8 të Konventës, për një shkelje të së drejtës së saj për t'iu respektuar shtëpia.

4. Më 6 tetor 2014, çështja iu komunikua Qeverisë.

FAKTET

5. Kërkuesja, znj. Violeta Pulfer, është një shtetase shqiptare, lindur në vitin 1967 dhe banuese në Tiranë.

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

6. Në një datë të paspecifikuar, në vitin 2011, kërkuesja dhe bashkëshorti i saj u shpërngulën në

Vlorë. Ankuesja pranoi të blinte një shtëpi, e cila ishte ndërtuar në mënyrë të paligjshme nga S.N. Ndërkohë, S.N. kishte paraqitur një kërkesë për rregullimin e statusit të paligjshëm të shtëpisë.

7. Më datë 19 tetor 2011, kërkuesja dhe S.N. lidhën një kontratë kapari, në bazë të së cilës kërkuesja depozitoi vetëm më pak se gjysmën e çmimit të shitjes si kapar, ndërsa pjesa tjetër do të paguhej pas zgjidhjes së çështjes së statusit të shtëpisë dhe pas lidhjes së kontratës së shitjes.

8. Më datë 8 dhjetor 2011, kërkuesja u shpërngul në shtëpi, sipas kontratës së kaparit.

A. Nxjerrja e kërkueses me forcë nga shtëpia

1. Përpjekja e parë për t'u nxjerrë nga shtëpia

9. Më datë 12 janar 2012, S.N. i kërkoi kërkueses të lironte shtëpinë. Kërkuesja kundërshtoi të dilte dhe i kujtoi S.N. detyrimet që dilnin nga kontrata e kaparit. Rezulton se në të njëjtën ditë, S.N. shkatërroi edhe një pjesë të pronës së luajtshme të kërkueses.

10. Më 1 shkurt 2012, S.N. dorëzoi një padi civile, ku kërkonte që kontrata e kaparit të deklarohej e pavlefshme dhe që atij t'i lejohej të rimerrte pronësinë e shtëpisë.

11. Më 3 maj 2012, Gjykata e Rrethit Vlorë e rrëzoi padinë dhe konstatoi se kontrata e kaparit ishte e vlefshme dhe e ligjshme. U konstatua edhe se kërkesa për rimarrjen në pronësi e shtëpisë nuk mbështetej në ligj. Duke qenë se ndaj këtij vendimi nuk u paraqit asnjë ankesë, vendimi u bë i formës së prerë më 18 maj 2012.

12. Rezulton se më datë 10 korrik 2012, statusi i shtëpisë u rregullua dhe, si rrjedhojë, S.N. fitoi dokumentet e pronësisë. Rezulton se, në vijim, midis S.N. dhe kërkueses nuk është lidhur asnjë kontratë shitje.

2. Përpjekja e dytë për nxjerrjen nga shtëpia

13. Në mëngjesin e datës 8 shtator 2012, S.N. hyri me forcë në shtëpi. Sipas kërkueses, ai i vendosi një litar në qafë, e tërhoqi zvarrë në tokë dhe e përplasi të muret rrethuese për rreth dhjetë minuta.

14. Në po të njëjtën ditë, kërkuesi i dërgoi mesazhe shefit të policisë dhe prokurorit të rrethit, duke kërkuar mbrojtjen e autoriteteve për të shmangur dhunën e mëtejshme. Ajo paraqiti si prova në Zyrën e Regjistrimit të Gjykatës, disa *screenshot* të mesazheve në fjalë, të marrë nga telefoni i saj celular. Sipas kërkueses, policia ndërhyri pas një orë e gjysmë.

15. Më datë 9 shtator 2012, bashkëshorti i kërkueses vuri re E.N., bashkëshorten e S.N., teksa hiqte vegla dhe objekte nga garazhi i shtëpisë. Në po të njëjtën ditë, kërkuesi shkoi në rajonin e policisë për të dorëzuar një padi penale ndaj S.N., për vjedhje.

16. Rezulton se më datë 10 shtator 2012, kërkuesja shkoi të jetonte në shtëpinë e nënës së saj në Tiranë.

17. Më datë 30 tetor 2012, me ndihmën e policisë, kërkuesja hyri në shtëpi dhe e gjeti atë të boshatisur.

B. Hetimet dhe procedimet penale ndaj S.N.

1. Hetimi i parë dhe grupi i procedimeve

18. Në një datë të paspecifikuar, në janar të vitit 2012, kërkuesja paraqiti një padi penale kundër S.N. për veprën e vetëgjyqësisë, mbështetur në nenin 277 të Kodit Penal ("KP").

19. Më datë 12 janar 2012, prokurori mori deklaratën e S.N. dhe E.N. për përpjekjet e tyre për të nxjerrë kërkuesen nga shtëpia.

20. Më datë 14 maj 2012, S.N. u akuzua për veprën e vetëgjyqësisë, sipas nenit 277 të KP-së.

21. Më datë 20 qershor 2012, prokurori e dërgonte S.N. në gjyq. Dosja e çështjes iu transmetua Gjykatës së Rrethit Vlorë, në mënyrë që kjo e fundit të realizonte procedimet.

22. Më datë 12 dhjetor 2012, Gjykata e Rrethit Vlorë vendosi të ndërpriste procedimet, mbështetur në nenin 387 të Kodit të Procedurës Penale ("KPP"), duke qenë se për këtë vepër ishte dhënë amnisti, sipas aktit të përgjithshëm të amnistisë (ligji nr. 107, i datës 8 nëntor 2012 mbi

amnistinë).

2. Hetimi i dytë

23. Më datë 8 shtator 2012, kërkuesja dorëzoi një tjetër padi penale ndaj S.N. për veprën e vetëgjyqësisë, mbështetur në nenin 277, të KP-së. Në po të njëjtën ditë, prokurori mori në pyetje S.N. në cilësinë e personit, ndaj të cilit kishte nisur një hetim.

24. Më datë 9 shtator 2012, kërkuesja dha një deklaratë përpara prokurorit duke u ankuar për ngjarjet në datë 8 dhe 9 shtator 2012 (shih paragrafët 13–15 më sipër). Ajo u ankua edhe për E.N. Në po të njëjtën ditë, E.N. u mor në pyetje për këtë ankesë, në cilësinë e personit ndaj të cilit kishte nisur një hetim.

25. Në vijim të agresionit të pretenduar, të datës 8 shtator 2012, më 9 shtator 2012, prokurori urdhëroi që kërkuesja t'i nënshtrohej një kontrolli mjekësor.

26. Më datë 10 shtator 2012, një oficer policie e referoi veprën e vetëgjyqësisë te prokurori.

27. Më datë 10 shtator 2012, kërkuesja u kontrollua një ekspert mjekoligjor. Raporti mjekësor konstatonte shenja të dukshme në qafën e kërkueses, si rezultat i shtrëngimit, si edhe hematoma në kokë si rezultat i goditjes me një objekt të fortë. Dëmtimet e mësipërme e kishin bërë kërkuesen të ishte në një gjendje të përkohshme pamundësie për të punuar, për një periudhë prej nëntë ditësh.

28. Nga dosja e çështjes rezulton se shëndeti i kërkueses filloi të përkeqësohej si rezultat i sulmit të datës 8 shtator 2012. Më pas, ajo kërkoi këshillë mjekësore prej ekspertëve në Greqi.

29. Më datë 14 shtator 2012, prokurori nisi hetimin penal nr. 1473 ndaj S.N. për plagosje të lehtë fizike me dashje dhe vetëgjyqësi sipas neneve 89 dhe 277 të KP-së. Një hetim u hap edhe ndaj E.N për vetëgjyqësi.

30. Më datë 4 tetor 2012, kërkuesja paraqiti një tjetër padi penale ndaj S.N. për, *inter alia*, veprat e kërcënimit, hyrjes me dhunë, sulmit, vjedhjes, shkatërrimit të pronës dhe përdorimit me keqdashje të thirrjeve telefonike, sipas neneve 84, 112, 119, 134, 150 dhe 275 të KP-së.

31. Më datë 4 tetor 2012, prokurori nisi hetimin penale nr.1588, ndaj S.N. për veprën e përdorimit me keqdashje i thirrjeve telefonike, sipas nenit 275 të KP-së.

32. Më datë 8 tetor 2012, prokurori vendosi të bashkonte dy hetimet, nr. 1473 dhe 1588.

33. Më 12 tetor 2012, S.N. dha një deklaratë përpara prokurorit.

34. Sipas një certifikate lëshuar nga spitali, më 27 nëntor 2012, tërhequr në Greqi, kërkuesja iu nënshtrua një disketomie serioze të diskut cervikal (një operacion për heqjen e diskut të qafës ose diskut degjenerativ në zonën e qafës që i përket shpinës) në Greqi. Pas kësaj, asaj iu desh të mbante një qafore për dy muaj.

35. Më 6 dhjetor 2012, pas deklaratës së bërë nga avokati i kërkueses se shëndeti i saj ishte përkeqësuar, dhe se ajo i ishte nënshtruar një operacioni si edhe një imazhimi me rezonancë magnetike për pjesën e qafës, prokurori urdhëroi një kontroll mjekësor nga e para. Avokati paraqiti edhe një listë të detajuar me objektet e kërkueses, të cilat kishin qenë brenda në shtëpi, në shtator 2012.

36. Më 17 janar 2013, ekspertët e mjekësisë ligjore konfirmuan se në trupin e kërkueses ishin gjetur shenja të shtrëngimit në qafë dhe hematoma në kokë, si rezultat i ngjarjeve më 8 shtator 2012, dhe një qepje (si rezultat i një ndërhyrje kirurgjikale). Dëmtimet e mësipërme i kishin krijuar asaj një pamundësi të përkohshme për të punuar, për një periudhë prej nëntë ditësh. Më tej, ata pohonin se mbështetur në dokumentet në dosjen e çështjes, më konkretisht certifikata spitalore e datës 27 nëntor 2012, imazhimit të rezonancës magnetike dhe raportit pas një konsulte me një neuropsikiatër të posaçëm, dëmtimi i konstatuar në imzhimin e rezonancës magnetike, nuk lidhej me ngjarjet e datës 8 shtator 2012; ato ishin shkaktuar si rezultat i kushteve që kishin ekzistuar përpara traumës.

37. Më 15 shkurt 2013, prokuroria konstatoi se S.N. dyshohej të kishte kryer veprat e parashikuara në nenet 89, 275 dhe 277 të KP-së. E.N. dyshohej të kishte kryer veprën e parashikuar

në nenin 277 të KP-së. Megjithatë, prokuroria vendosi të ndërpriste hetimin, duke qenë se ishte dhënë amnisti për veprat e pretenduara, sipas aktit të përgjithshëm të amnistisë. Vendimi i referohej edhe dy kontrolleve mjeko-ligjore të datës 10 shtator 2012 dhe 17 janar 2013. Vendimi, për sa ka lidhje me çështjen, arsyeton si më poshtë:

"... sipas kontrollit mjekoligjor të datës 10 shtator 2012, u konstatua se dëmet në trup e kishin bërë atë të mos ishte në gjendje të punonte përkohësisht, për më shumë se nëntë ditë.

...

[Kërkuesja] pretendon se ditën e aksidentit, ajo kishte marrë dëmtime serioze fizike, për shkak të tyre asaj iu desh t'i nënshtrohej një ndërhyrje kirurgjikale. Më 6 dhjetor 2012, ajo iu nënshtrua një kontrolli mjekoligjor, i cili u realizua më 17 janar 2013... u konstatua se dëmtimet fizike e kishin bërë atë përkohësisht të mos ishte në gjendje të punonte, për më shumë sesa nëntë ditë. Dëmtimet duhet të shqyrtohen sipas veprës për dëmtim fizik, parashikuar në nenin 89 të Kodit Penal.

...

Në mbështetje të informacionit të marrë gjatë hetimit..., rezulton se nga data 24 deri më 27 shtator 2012, S.N. ka shqetësuar Violeta Pulfer me telefonata, dhe e ka kërcënuar për të mos e lejuar të kthehej në shtëpinë të cilën kishte blerë. Në këto rrethana, dyshohet se S.N. dhe E.N. kanë kryer veprën e parashikuar në nenin 277 të Kodit Penal, ndërsa S.N. po ashtu [dyshohet të ketë kryer] veprat e parashikuara në nenet 89 dhe 275 të Kodit Penal...

Më 28 nëntor 2012, [akti i përgjithshëm i amnistisë] hyri në fuqi. Seksioni 5 parashikon ndërprerjen e ndjekjes penale për të gjitha veprat e kryera deri më 30 shtator 2012, për të cilat Kodi Penal parashikon një dënim me burg deri në dy vjet ose një dënim më të lehtë/

...

Veprat e parashikuara në nenet 89, 277 dhe 275 të Kodit Penal, për të cilat janë nisur hetimet, kanë një periudhë maksimale dënimi me burg për dy vjet, dhe janë kryer përpara datës 30 shtator 2012. Në këto rrethana, ka arsye që procedimi penal të mos vijojë."

38. Kërkuesja paraqiti përpara Prokurorit të Përgjithshëm të Shqipërisë një ankesë ndaj vendimit të prokurorit, i cili i përket datës 15 shkurt 2013. Ajo kërkoi që procedimi të vijonte nga prokurori i rrethit për veprën e vjedhjes në bashkëpunim me të tjerë, shkatërrimit të pronës, torturës dhe ndalimit me anë të kanosjeve dhe të dhunës për të gëzuar të drejtën e njohjes së pronës, sipas neneve 134, 150, 86, 109/b të KP-së, respektivisht. Gjithashtu, ajo u ankua për mungesë të paanshmërisë nga ana e prokurorit.

39. Më 25 prill 2013, ankueses iu dha statusi për paaftësi të plotë dhe u njoh si përkohësisht e paaftë për të punuar.

40. Më 11 korrik 2014, Prokurori i Përgjithshëm e dërgoi dosjen në prokurorinë e rrethit Fier për procedimet në lidhje me ankesën e kërkueses mbi paanshmërinë e prokurorit të rrethit Vlorë.

41. Më 2 dhe 3 nëntor 2017, Qeveria dhe kërkuesi, respektivisht, informuan Gjykatën se kërkuesja kishte paraqitur një ankesë në Gjykatën e Rrethit Vlorë, ndaj vendimit të prokurorit të datës 15 shkurt 2013, sipas nenit 329 të KPP-së.

42. Më 18 maj 2015, Gjykata e Rrethit Vlorë pushoi ankesën e kërkueses. Ajo konstatoi se prokurori kishte ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm procedues dhe se procedimet ishin ndërprerë rregullisht në respektim të aktit të përgjithshëm të amnistisë.

43. Më 15 shtator 2015, Gjykata e Apelit Vlorë pushoi apelimin e bërë nga kërkuesja për të njëjtat arsye të paraqitura edhe nga Gjykata e Rrethit Vlorë. Po ashtu, ajo vërejti se kërkuesja nuk kishte parashtruar përpara gjykatave vendase faktin se prokuroria kishte pushuar procedimet.

44. Më 14 korrik 2016, Gjykata e Lartë la në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit të datës 15 shtator 2015.

3. Hetimi i tretë

45. Në një datë të papërcaktuar, kërkuesja paraqiti një tjetër padi penale ndaj S.N. dhe E.N. për veprën e vjedhjes sipas nenit 134 të KP-së.

46. Më 3 nëntor 2017, kërkuesja bëri me dijeni Gjykatën për rezultatin e procesit të tretë.

47. Më 2 nëntor 2012, prokurori nisi hetimin nr. 1762 ndaj S.N. dhe E.N për veprën e vjedhjes,

sipas nenit 134 të KP-së në lidhje me ngjarjen e datës 30 tetor 2012.

48. Më 6 dhjetor 2012, kërkuesja paraqiti një tjetër kërkesë përpara prokurorit, duke u ankuar, midis të tjerash, për vjedhjen e sendeve të saj personale, më 30 tetor 2012.

49. Më 13 mars 2013, prokuroria e klasifikoi veprën si vetëgjyqësi, sipas nenit 277 të KP-së.

50. Më 10 prill 2014, Gjykata e Rrethit Vlorë ndërpreu procedimet mbështetur në nenin 387 të KPP-së, duke qenë se ishte dhënë amnisti për veprën në mbështetje të aktit të përgjithshëm të amnistisë.

4. Informacione të reja për një proces të katërt dhe grupi i procedimeve

51. Më 3 nëntor 2017, kërkuesja informoi Gjykatën, se në një datë të papërcaktuar, në vitin 2014, ajo kishte paraqitur në prokurorinë Tiranë, një tjetër ankesë ndaj S.N. për veprat e kanosjes, plagosjes së rëndë me dashje dhe të ofendimi, në mbështetje të neneve 84, 88 dhe 119 të Kodit Penal. Kërkuesja ishte ankuar edhe për faktin se raporti mjekësor i datës 17 janar 2013 mbështetej në dokumente të falsifikuara dhe se vepra e plagosjes së rëndë me dashje ishte kryer, në fakt.

52. Më 30 qershor 2014, prokurori në Tiranë, pas kryerjes së disa veprimeve hetuese, vendosi të mos e dërgonte çështjen për gjykim me arsyetimin se nuk kishte elementë të krimit. Ai arsyetonte se imazhet e rezonancës dhe konsulta me neuropsikiatrin, te të cilat ishte mbështetur raporti mjekësor, nuk kishin lidhje me ngjarjet e datës 8 shtator 2012.

53. Më 3 dhjetor 2014, Gjykata e Rrethit Tiranë, pas kërkesës dërguar nga kërkuesja, vendosi ta anulonte vendimin e prokurorit dhe e urdhëroi atë të vijonte me hetimet. Ajo gjykoi se prokurori duhej të shqyrtonte provat e paraqitura nga kërkuesja si edhe çdo provë ose pretendim tjetër në lidhje me to, për të realizuar në këtë mënyrë një hetim të plotë.

54. Më 6 tetor 2015, Gjykata e Apelit Tiranë, pas një apelimi të bërë nga prokurori, la në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit të datës 3 dhjetor 2014.

55. Në shkurt 2018, Qeveria informoi Gjykatën për zhvillimet e mëtejshme. Më datë 6 dhjetor 2017, prokuroria Tiranë regjistroi procedimet penale për falsifikim dokumentesh. Më 11 dhjetor 2017, prokuroria Tiranë shpalli mungesën e kompetencës dhe ia transferoi çështjen prokurorisë së Vlorës, e cila e regjistroi çështjen nr. 9854, më 14 dhjetor 2017. Rezulton se hetimi po vijon ende. Megjithatë, Qeveria pohoi se ky grup procedimesh nuk kishte asnjë lidhje me ankesat e kërkueses.

II. LIGJI DHE PRAKTIKA PËRKATËSE VENDËSE

A. Kodi Penal ("KP")

56. Neni 84 parashikon se kundërvajtja e kanosjes dënohet me burgim deri në një vit.

Neni 88 parashikon se vepra e plagosjes së rëndë me dashje, e cila sjellë si pasojë gjymtimin, shëmtimin ose çdo dëmtim tjetër të shëndetit të personit ose ka qenë e rrezikshme për jetën në çastin e shkaktimit të saj, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet.

Neni 89 parashikon se vepra e plagosjes së lehtë me dashje, që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se 9 ditë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Neni 109/b parashikon se vepra e shtrëngimit me anë të kanosjes ose dhunës për përvetësimin e pronës dënohet me burgim deri në tetë vjet.

Neni 112 parashikon se vepra e hyrjes ose e qëndrimit me forcë në pronën e tjetri, dënohet me burgim deri në një vit.

Neni 119 parashikon se vepra e fyerjes dënohet me gjobë deri në 1 milion lekë shqiptarë.

Neni 134§1 parashikon se vepra e vjedhjes dënohet me burgim deri në tre vjet. Nëse kryhet në bashkëpunim me të tjerë, ajo dënohet me burgim deri në pesë vjet (neni 134§2). Në rastin e përdorimit të dhunës, vjedhja dënohet me burgim deri në pesëmbëdhjetë vjet (neni 139).

Neni 150 parashikon se vepra e shkatërrimit të pronës dënohet me burgim deri në tre vjet.

Neni 275 parashikon se vepra e përdorimit me keqdashje të thirrjeve telefonike dënohet me

burgim deri në një vit.

Sipas nenit 277, vepra e vetëgjyqësisë, e cila është ushtrimi i një të drejte prej personit që i përket ose që kujton se i përket dhe që nuk njihet nga tjetri pa iu drejtuar organit kompetent shtetëror, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre muaj.

B. Kodi i Procedurës Penale ("KPP")

57. Dispozitat përkatëse të KPP-së, në fuqi në kohën respektive, parashikojnë si më poshtë.

58. Sipas nenit 61, një person i cili ka pësuar dëm nga vepra penale mund të ngrejë padi civile në procesin penal, për të kërkuar shpërblimin e dëmit. Sipas nenit 62§2, padia duhet të dorëzohet përpara fillimit të shqyrtimit gjyqësor. mbështetur në nenin 62§3, gjykata mund të vendosë veçimin e padisë civile dhe dërgimin e saj në gjykatën civile nëse gjykimi i saj vështirëson ose zvarrit procesin penal.

59. Neni 284 parashikon, midis të tjerash, se veprat të cilat shkaktojnë dëm fizik dhe përdorim keqdashës të thirrjeve telefonike, të parashikuara në nenet 89 dhe 275 të Kodit Penal duhet të hetohen nga prokurori vetë nëse pala e dëmtuar ka paraqitur një padi penale. Edhe pse në Kodin Penal nuk ka asnjë dispozitë specifike, parashikimi në nenin 284 përjashton nga hetimi veprat e tjera të parashikuara në paragrafin 58 më sipër, vetëm në rastin e një padie penale nga pala e dëmtuar. Për këtë arsye, ato mund të ndiqen penalisht nga prokuroria me mocionin e saj.

60. Neni 328§f parashikon të drejtën e prokurorit për të ndërprerë ndjekjen penale, në rastin kur, midis situatave të tjera, kjo gjë parashikohet me ligj. Neni 329 parashikon të drejtën për të apeluar në një gjykatë rrethi kundër vendimit të prokurorit për të ndërprerë hetimin. Në gjykatën e apelit mund të paraqitet një ankesë kundër vendimit të gjykatës së rrethit. Neni 387 i KPP-së parashikon se gjykata e rrethit mund të pushojë çështjen nëse ndjekja penale nuk duhet të nisë ose nuk duhet të vijojë, ose nëse vepra është shuar.

C. Kodi Civil

61. Neni 608 i Kodit Civil parashikon se cilido i cili i shkakton tjetrit një dëm në personin ose në pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar. Ai ose ajo nuk përgjigjet kur provon se nuk ka faj. Neni 609 parashikon se dëmi duhet të jetë rezultat i veprimit ose mosveprimit të drejtpërdrejtë të një personi. Neni 625 parashikon se personi që pëson një dëm jopasuror ka të drejtë të shpërblehet kur: a) ka pësuar një dëmtim të shëndetit, të integritetit fizik ose psikik të tij; b) është cenuar nderi, personaliteti ose reputacioni i tij; c) është cenuar e drejta e emrit; ç) është cenuar respektimi i jetës private. Sipas nenit 640, dëmi pasuror që shpërblehet përbëhet nga humbja e pësuar dhe fitimi i munguar. Sipas nenit 641, personi që i ka shkaktuar tjetrit një dëm në shëndetin e tij, detyrohet ta shpërblejë dëmin.

D. Akti i përgjithshëm i amnistisë (ligji nr. 107/2018 i datës 8 nëntor 2012, për amnistinë)

62. Sipas seksionit 5 të aktit të përgjithshëm të amnistisë, një ndjekje penale nuk mund të fillojë ose nëse ka filluar tashmë, ajo duhet të pushohet, për veprat e kryera përpara datës 30 shtator 2012, për të cilat KP-ja parashikon një dënim me burg deri në dy vjet ose dënime të tjera më të lehta.

LIGJI

I. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 3 TË KONVENTËS

63. Kërkuesja u ankua se dështimi i autoriteteve për të mbrojtur jetën e saj, e cila ishte përballur me rrezik serioz për shkak të akteve të dhunshme të një individi, si edhe pamundësia e autoriteteve për të vijuar ndjekjen dhe procedimet penale ndaj S.N. kishte shkelur nenet 2 dhe 6 të Konventës.

64. Gjykata, ka kompetencën të japë karakteristikat e fakteve të çështjes, konstaton se, në mungesë të një kanosje serioze për jetën e kërkueses, ankesat e mësipërme të lidhura me integritetin e saj fizik do të shqyrtohen në mbështetje të nenit 3 të Konventës (shih *Valiulienė kundër Lituanisë*, nr. 33234/07, §42, 26 mars 2013 dhe *Radomilja dhe të Tjerët kundër Kroacisë* [DHM], nr. 37685/10 dhe 22768/12, §§ 126–127, 20 mars 2018), i cili parashikon si më poshtë:

Neni 3

"Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose degraduese".

A. PRANUESHMËRIA

1. Parashtrimet e palëve

65. Qeveria parashtroi se procedimet penale në lidhje me falsifikimin e dokumenteve nuk ishin të lidhura me ankesat e kërkueses, sipas neneve 3 dhe 8 të Konventës (shih paragrafët 44–48 më sipër).

66. Qeveria parashtroi se trajtimi, subjekt i të cilit kishte qenë kërkuesja, nuk arrinte nivelin minimal të dhunës për t'u klasifikuar nën objektin e nenit 3 të Konventës. Në lidhje me gjendjen serioze të dëmtimeve të pësuara nga kërkuesja dhe efektet e trajtimit, të ushtruar ndaj saj, Qeveria vëren se dhuna nuk kishte qenë e paramenduar ose e vazhduar,, dhe mbështetur në faktin se kërkuesja ishte përfshirë në konfrontim fizik nuk e kishte lejuar situatën të kalonte në ndonjë motiv degradues. Për më tepër, nuk ishte provuar, "përtej dyshimit të arsyeshëm" se kërkuesja ishte përballur me akte që binin në kundërshtim me nenin 3 të Konventës. Përkeqësimi i shëndetit të saj kishte qenë rezultat i konfrontimit midis ankueses dhe S.N.

67. Më tej, Qeveria parashtroi se kërkuesja nuk kishte përdorur mjetet e brendshme të disponueshme. Sidoqoftë, kërkuesja duhej të kishte shfrytëzuar mjetet e brendshme civile. Sipas praktikës ligjore, Qeveria parashtroi se kërkuesja mund të kishte paraqitur një kërkesë për dëmshpërblim, në mbështetje të neneve 608, 625 dhe 640 të Kodit Civil, si edhe vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë, të datës 14 shtator 2007, ose një padi civile në kuadër të procedimeve penale, sipas nenit 61 të KPP-së.

68. Kërkuesja parashtroi se dokumentet në dosjen e çështjes tregonin se ndaj saj ishte përdorur forcë dhe se përkeqësimi i shëndetit të saj ishte rezultat i akteve të dhunshme nga S.N.

69. Në vijim, kërkuesja parashtroi se ajo tashmë kishte përdorur mjetet e mundshme të brendshme. Për këtë arsye, nuk duhej të pritej që ajo të kishte përdorur mjete të tjera të brendshme. Çështja e saj ndryshonte nga praktika gjyqësore e parashtruar nga Qeveria. Për më tepër, ajo nuk i ishte adresuar Gjykatës me një kërkesë të drejtpërdrejtë për kompensim; në të vërtetë ankesa e saj përqendrohej në paaftësinë e Qeverisë për të mbrojtur jetën dhe shëndetin e saj.

2. Vlerësimi i Gjykatës

a) Në lidhje me shterimin e mjeteve të brendshme

70. Në lidhje me kundërshtimin e Qeverisë për mosshfrytëzim të mjeteve të brendshme, Gjykata vëren se për krimet e pretenduara të ishin kryer nga S.N. dhe E.N. ishin hapur të paktën procese penale. I pari dhe i katërti u pushuan me anë të një vendimi gjykate (hetimet e para dhe të treta), dy të tjerët (bashkuar në hetimin e dytë) u pushuan me anë të një vendimit të prokurorit. Të gjitha vendimet u morën duke zbatuar një amnisti të përgjithshme. Më tej, Gjykata vëren se kërkuesja apeloi ndaj vendimit të prokurorit të datës 15 shkurt 2013 (procesi i dytë, i cili ishte i lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me ankesën e saj për sulm fizik)tek gjykatat vendëse, por pa efikasitet. Më tej, ajo u ankua te Prokuroi i Përgjithshëm. Në lidhje me procesin e pestë (grupi i katërt i procedimeve), Gjykata vëren se pas një apelimi të kërkueses paraqitur në gjykatat vendëse ndaj vendimit të prokurorit për të mos e dërguar çështjen për gjykim, procesi është ende pezull te prokurori. Për këtë arsye, Gjykata vlerëson se kërkuesja tashmë i ka përdorur mjetet e mjaftueshme, në lidhje me procedimet penale, siç parashikohet në ligjin e brendshëm dhe për këtë arsye, ajo e rrëzon kundërshtimin e Qeverisë për këtë aspekt.

71. Në vijim, Gjykata thekson se parandalimi me efikasitet i akteve serioze, të tilla si sulmet e qëllimshme ndaj integritetit fizik të një personi, ku rrezikohen vlerat themelore dhe aspekte thelbësore të jetës private, kërkon parashikime efikase nga legjislacioni penal. Mjetet civile të referuara nga Qeveria nuk mund të konsiderohen si të mjaftueshme për përmbushjen e detyrimeve të shtetit kontraktues, sipas nenit 3 të Konventës, në raste të tilla si çështja konkrete, sepse ato kanë

për qëllim kompensimin më shumë sesa identifikimin dhe dënimin e personave përgjegjës (shih *Sanda Jankovic kundër Kroacisë*, nr. 38478/05, §36, 5 mars 2009; *Beganovic kundër Kroacisë*, nr. 46423/06, §56, 25 qershor 2009; dhe *Remetin kundër Kroacisë*, nr. 29525/10, §76, 11 dhjetor 2012).

72. Për këtë arsye, Gjykata rrëzon kundërshtimin e Qeverisë për këtë aspekt.

b) Në lidhje me faktin nëse kërkuesja është bërë objekt i akteve, të cilët janë në kundërshtim me nenin 3 të Konventës

73. Gjykata vëren se çështja e zbatueshmërisë së nenit 3, është një çështje e juridiksionit të Gjykatës *ratione materiae*, për këtë arsye duhet të respektohet rregulli i përgjithshëm për trajtimin e kërkesave si edhe duhet të kryhet analiza përkatëse për fazën e pranueshmërisë, në rast se nuk ka arsye për ta bashkuar këtë aspekt me themelin. Në çështjen konkrete nuk ekziston asnjë arsye e tillë. Në këtë mënyrë, zbatueshmëria e nenit 3 mbetet të trajtohet në fazën e pranueshmërisë së konventës (shih *Denisov kundër Ukrainës* [DHM], nr. 76639/11, §93, 25 shtator 2018).

74. Gjykata thekson se keqtrajtimi duhet të përkojë me një nivel minimal rreziku, në rast se synohet që të përfshihet në objektin e nenit 3. Vlerësimi i këtij niveli minimal varet nga të gjitha rrethanat e çështjes, të tilla si kohëzgjatja e trajtimit, efektet e tij fizike ose mendore, dhe në disa raste, gjinia, mosha dhe gjendja shëndetësore e viktimës. Gjithashtu, konsideratë i duhet kushtuar edhe kontekstit në të cilin është ushtruar keqtrajtimi, si për shembull atmosfera e një tensioni dhe e mocioneve të forta. Gjykata vlerëson se trajtimi ka qenë "çnjerëzor", sepse, *inter alia*, ishte i paramenduar, ishte ushtruar për orë të tëra dhe kishte shkaktuar dëmtime fizike ose vuajtje intensive fizike dhe mendore (shih *Valiuliene*, cituar më sipër, §65–66 dhe referencat e cituara në të).

75. Duke u rikthyer në rrethanat e çështjes në fjalë, Gjykata vëren se kërkuesja ishte bërë objekt i dhunës. Fillimisht, Gjykata nënvizon dhunën fizike të ushtruar ndaj kërkueses. Siç edhe konfirmohet nga gjetjet e raportit mjekoligjor, te kërkuesja ishin të dukshme shenjat e shtrëngimit rreth qafës dhe hematoma në kokë, si rezultat i sulmit. Kërkuesja ishte në pamundësi për të punuar për më shumë se nëntë ditë. Më tej, Gjykata vlerëson se sulmi, në vetvete, mund të ketë krijuar te kërkuesja ndjenjën e pasigurisë, të ankthit dhe të stresit, përderisa ajo kishte frikë të kthehej në shtëpinë ku kishte jetuar më herët për pak muaj. Në lidhje me sa përmendet më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se keqtrajtimi i kombinuar me ndjenjat e frikës dhe të pafuqisë te kërkuesja ishin mjaftueshëm serioze për të përmbushur nivelin e një situate serioze sipas nenit 3 të Konventës dhe në këtë mënyrë çon në detyrimin pozitiv të Qeverisë, sipas këtij parashikimi (po këtu, §70).

c) Përfundim

76. Gjykata konstaton se ankesa, në mbështetje të nenit 3 të Konventës nuk është haptazi e pambështetur në fakte, sipas interpretimit të nenit 35§3 të Konventës. Në vijim ajo konstaton se ajo nuk është e papranueshme për ndonjë arsye tjetër. Prandaj, ajo duhet të deklarohet e pranueshme.

B. Themeli

1. Parashtrimet e palëve

77. Në parashtrimin e saj kërkuesja, shpjegonte se prokurori kishte filluar hetimin penal ndaj S.N. vetëm për shkaktimin e dhunës fizike, vetëgjyqësi dhe përdorimin keqdashës të thirrjeve telefonike, edhe pse ajo kishte paraqitur padi penale për vrasje të mbetur në tentativë, vjedhje përmes ushtrimit të dhunës, hyrjes me dhunë dhe shkatërrimit të pronës, sipas neneve 76, 139, 112 dhe 150 të Kodit Penal. Në parashtrimet e saj fillestare dhe në ato shtesë, të datës 3 nëntor 2017, kërkuesja deklaroi se ajo kishte ndërmarrë procedura për vërtetësinë e raportit mjeko-ligjor, të datës 17 janar 2013, me argumentin se ndaj saj ishin kryer vepra më të rënda sesa shkaktimi i dëmit fizik. Ajo kishte marrë statusin e paaftësisë së plotë, dhe përkeqësimi i shëndetit kishte qenë rezultat i dhunës që S.N. kishte përdorur ndaj saj.

78. Qeveria parashtroi se kuadri ligjor në nivel të brendshëm kishte ofruar një kuadër të mjaftueshëm rregullator për të ndjekur në mënyrë penale aktet e dhunshme të pretenduara nga kërkuesja. Autoritetet vepruan me kujdesin e duhur. Hetimet dhe procedimet penale që pasuan kishin qenë mjaftueshëm efikase, të shpejta dhe të suksesshme. Përdorimi i mjeteve të legjislacionit penal nga kërkuesja nuk kishte pasur sukses për arsye të cilat nuk vareshin nga veprimet e autoriteteve.

2. Vlerësimi i Gjykatës

a) Parimet e përgjithshme për detyrimet pozitive të shtetit, të zbatueshme në çështjen konkrete

79. Gjykata thekson se masat efikase parandaluese ndaj akteve të rënda, të tilla si ato në çështjen në fjalë, mund të arrihen vetëm me anë të ekzistencës së dispozitave efikase në legjislacionin penal, të mbështetura nga makineria ligjzbatuese (*X dhe Y kundër Holandës*, 26 mars 1985, §27 seritë A, nr. 91, *Beganović*, cituar më sipër, §71, *Mahmut Kaya kundër Turqisë*, nr. 22535/93, §115, GJEDNJ 2000–III dhe *M.C. kundër Bullgarisë*, nr. 39272/98, §150, GJEDNJ 2003–XII).

80. Për më tepër, është i vetëkuptueshëm fakti se detyrimi ndaj shtetit, sipas nenit 1 të Konventës, nuk mund të interpretohet si një kërkesë ndaj shtetit që me anë të sistemit të tij ligjor të garantojë që një individ të mos ushtrojë trajtim çnjerëzor ose degradues, ose nëse një gjë e tillë ndodh, procedimet penale duhet të çojnë detyrimisht drejt një sanksioni të caktuar. Në mënyrë që shteti të mbajë përgjegjësinë, sipas Gjykatës, duhet të tregohet se sistemi i brendshëm ligjor, dhe veçanërisht ligji penal i zbatueshëm në rrethanat e çështjes, dështon të ofrojë mbrojtje praktike dhe efikase për të drejtat të cilat garantohen me anë të nenit 3 (shih *Beganović*, cituar më sipër, §71, dhe *Valiuliene*, cituar më sipër, §75).

81. Në këto rrethana, duhet të shtohet se nuk është detyrë e Gjykatës të verifikojë nëse prokurorët dhe gjykatat vendëse kanë zbatuar ligjin penal vendës në mënyrë korrekte. Ajo çfarë diskutohet në çështjen konkrete nuk është problemi i legjislacionit penal, por përgjegjësia e shtetit sipas Konventës. Gjykata duhet të respektojë zgjedhjen e masave të duhura nga gjykatat vendëse, duke ruajtur në të njëjtën kohë pushtetin për të shqyrtuar dhe për të ndërhyrë në çështjet me dispropocion të dukshëm midis nivelit se sa i rëndë ka qenë akti dhe rezultateve të arritura në nivel vendës (shih, *mutatis mutandis*, *Nikolova dhe Velichkova kundër Bullgarisë*, nr. 7888/03, §62, 20 dhjetor 2007; *Atalay kundër Turqisë*, nr. 1249/03, §40, 18 shtator 2008; dhe *Valiuliene*, cituar më sipër, §76).

82. Sipas karakterit absolut të së drejtës së garantuar, Gjykata nuk e përjashton mundësinë se neni 3 i Konventës mund të zbatohet edhe kur rreziku shkaktohet nga persona ose grupe personash, të cilët nuk janë zyrtarë publikë. Megjithatë, duhet të provohet se rreziku është real dhe se autoritetet e shtetit përkatës nuk kanë mundësi ta shmangin rrezikun duke garantuar mbrojtjen e duhur (shih, *mutatis mutandis H.L.R. kundër Francës*, 29 prill 1997, §40, *raportet e vendimeve dhe e vendimeve* 1997–III).

83. Për më tepër, amnistia ose falja nuk pajtohet me detyrën e shtetit për të hetuar aktet e keqtrajtimit dhe për të luftuar pandëshkueshmërinë (shih, *mutatis mutandis, Abdülsamet Yaman kundër Turqisë*, nr. 32446/96, §55, 2 nëntor 2004; dhe *Ateşoğlu kundër Turqisë*, nr. 53645/10, §25, 20 janar 2015). Gjykata vlerëson se ky parim zbatohet në rastin e akteve midis individëve privatë për aq sa trajtimi arrin pragun, sipas nenit 3 të Konventës.

a) Zbatimi i parimeve të mësipërme në çështjen konkrete

84. Gjykata vlerëson në fillim se për sa u përket mekanizmave të legjislacionit penal, të parashikuar nga sistemi ligjor shqiptar në lidhje me detyrimet e shtetit, sipas nenit 3 të Konventës, Kodi Penal përcakton si specifike veprat të cilat shkaktojnë dëmtime fizike dhe dëmtime të rënda fizike. Vepra e shkaktimit të dëmtimit fizik, sipas nenit 89 të KP-së, hetohet nga një prokuror vetëm pas paraqitjes së një kërkese nga pala e dëmtuar, ndërsa për veprën e shkaktimit të dëmtimit të rëndë serioz, sipas nenit 88 të KP-së, prokuroria ruan të drejtën të hapë hetim penal me mocionin e vet.

Për më tepër, Gjykata vërën se edhe vepra të tjera ngarkuar S.N.-së nga kërkuesja, si për shembull përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike, kanosja, vetëgjyqësia dhe të tjera, sipas Kodit Penal parashikohen si vepra specifike. Për këtë arsye, Gjykata pranon se ligji shqiptar ka garantuar një kuadër të mjaftueshëm rregullator për të ndjekur penalisht krimet atribuar S.N-së nga kërkuesja.

85. Megjithatë, sipas parimit se Konventa nuk ka për qëllim të garantojë të drejtat teorike apo ato të mbështetura në iluzione, por të garantojë të drejtat praktike dhe efikase, Gjykata duhet të sigurohet se detyrimi i shtetit për të mbrojtur të drejtat e personave nën juridiksionin e tij, përmbushte në mënyrën e duhur në praktikë (shih, *Ž. B. kundër Kroacisë*, nr. 47666/13, §59, 11 korrik 2017). Për këtë arsye, Gjykata tashmë duhet të shqyrtojë nëse mënyra se si u përdorën mekanizmat e legjislacionit penal në çështjen në fjalë, kishte të meta deri në pikën saqë mund të përbënte një shkelje në këndvështrimin e detyrimeve të shtetit të paditur, sipas nenit 3 të Konventës (shih, *Valiuliene*, cituar më sipër, §79, dhe, *mutatis mutandis, Bălşan*, cituar më sipër, §64).

86. Gjykata vlerëson se gjatë hetimeve të para, të dyta dhe të treta, prokurori hapi një hetim penal dhe ndërmori një sërë masash procedurale. Megjithatë, hetimet dhe procedimet përkatëse u ndërprenë sipas një amnistie të përgjithshme. Për pasojë, autori (autorët) i krimit i krimeve të pretenduara nuk u gjykuan.

87. Duke iu kthyer çështjes së përgjegjësisë së shtetit, sipas nenit 3 të Konventës, Gjykata fillimisht, përsërit se, brenda kufijve të Konventës, zgjedhja e mjeteve për të siguruar përputhshmërinë me nenin 3 në sferën e marrëdhënieve të individëve midis njëri-tjetrit, në parim, është një çështje që kategorizohet në margjinën e vlerësimit të autoriteteve të brendshme, në rast se mekanizmat e legjislacionit penale janë të disponueshëm për viktimën (shih, *Beganović*, cituar më sipër, §86). Në këtë mënyrë, dhe për sa ka të bëjë me rrethanat e çështjes në fjalë, nuk i takon Gjykatës të spekulojë nëse prokurori duhet të kishte ndjekur hetimet penale sipas neneve të tjerë të Kodit Penal siç sugjerohet nga kërkuesja (shih paragrafët 31 dhe 77 më sipër, dhe *Valiuliene*, cituar më sipër, §85). Në këto rrethana, është e faktuar se rrethanat e çështjes konkrete nuk u provuan kurrë nga një gjykatë kompetente. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se një nga qëllimet për ushtrimin e sanksioneve penale është të kufizohet dhe të parandalohet autori i krimit nga shkaktimi i dëmeve të mëtejshme. Më tej, Gjykata vlerëson se në rastet e torturës ose keqtrajtimit, amnistitë dhe faljet nuk duhet të tolerohen (shih *Mocanu dhe të Tjerët kundër Rumanisë* [DHM], nr. 10865/09, dhe 2 të tjerë, §326, GJEDNJ 2014 (ekstrakte). Në këtë aspekt, Gjykata arrin në përfundimin se edhe pse kuadri ligjor në fuqi mund të ketë pasur një efekt mjaftueshëm parandalues, ku ky i fundit u shua me anë të ligjit për amnistinë.

88. Gjykata vëren se kërkuesja u përpoq të shuante efektet e kundërta, të cilat erdhën si rezultat i dhënies së amnistisë së përgjithshme, duke paraqitur një ankesë tjetër ndaj S.N. në vitin 2014, për, midis veprave të tjera, kanosjen dhe shkaktimin e dëmeve të rënda fizike, ku kjo e fundit dënohet me burg deri në dhjetë vjet. gjykata thekson se prokurori mori masa të menjëhershme për të nxjerrë S.N. përpara drejtësisë. Megjithatë, duke pasur parasysh mungesën e të dhënave, ai vendosi të mos e çonte çështjen në gjykatë. Në vijim të apelimeve të vazhdueshme nga kërkuesja, gjykatat vendase e anuluan vendimin e prokurorit për mungesë detajimesh (shih paragrafët 51–55, më sipër). Po ashtu, Gjykata vëren se u ndoqën penalisht vetëm veprat e lehta.

89. Në vijim, Gjykata thekson se pasi gjykatat vendase kishin vendosur ta dërgonin çështjen te prokurori për hetim të mëtejshëm, ky i fundit nuk kishte marrë ende një vendim.

90. Sipas gjykimit të Gjykatës, mënyra në të cilën mekanizmat e legjislacionit penal të cilët u zbatuan në çështjen në fjalë, specifikisht, zbatimi i amnistisë së përgjithshme, që rezultoi në ndërprerjen e tre hetimeve penale të para ndaj agresorit të pretenduar, ishte me të meta, deri në pikën që përbënte një shkelje të detyrimeve pozitive të shtetit përkatës, sipas Konventës në lidhje me pretendimet e kërkueses për sulm. Për këtë arsye, Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të nenit

3 të konventës.

III. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 8 TË KONVENTËS

91. Kërkuesja u ankua edhe për një shkelje të së drejtës së saj për respektimin e shtëpisë, jetës dhe pronës së saj, sipas nenit 8 të Konventës, i cili për sa ka të bëjë me rastin konkret parashikon:

Neni 8

"Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij."

92. Në parashtrimet e saj, kërkuesja thekson se autoritetet nuk kishin mundur të mbronin shëndetin, jetën dhe pronën e saj, sipas nenit 8. Deri më sot, kërkuesja nuk e ka informuar Gjykatën, nëse ajo ka mundur të hyjë në shtëpi.

93. Gjykata, e cila është kompetente për specifikimin e fakteve të çështjes, sipas ligjit, konstaton se kjo ankesë lidhet me integritetin fizik dhe psikologjik të kërkuesit i cili lidhet me konceptin e jetës private, sipas nenit 8 të Konventës (shih *Remetin*, cituar më sipër, §90).

94. Gjykata vlerëson se, përderisa ankesa e kërkueses, sipas nenit 8 të Konventës mbështetet në të njëjtat fakte, duhet të deklarohet edhe e pranueshme.

95. Në lidhje me përfundimin e Gjykatës për shkeljen e nenit 3 të Konventës dhe për faktin se kërkuesja nuk mundi t'i përgatiste ankesat e saj sipas nenit 8 të Konventës, edhe pas komunikimit të çështjes Qeverisë, Gjykata konstaton se nuk është e nevojshme që ankesa të shqyrtohet veçuar, për sa i përket nenit 8 të Konventës.

IV. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVE-NTËS

96. Neni 41 i Konventës parashikon:

"Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj, dhe nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar."

97. Kërkuesja nuk paraqiti kërkesë për shpërblim të drejtë. Gjykata konstaton se nuk ka asnjë kërkesë për ta adresuar çështjen me mocionin e saj.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA,

1. *E deklaron* kërkesën të pranueshme;

2. Vendos në mënyrë unanime, se është shkelur neni 3 i Konventës;

3. Vendos me gjashtë vota pro dhe një kundër se nuk ka nevojë të shqyrtohet ankesa, në këndvështrim të nenit 8 të Konventës.

Hartuar në anglisht dhe shpallur me shkrim më 20 nëntor 2018, sipas rregullit 77§2 dhe 3 të rregullores së Gjykatës.

Hasan Bakırcı
ZËVENDËSSEKRETAR

Robert Spano
KRYETAR

Sipas nenit 45§2 të Konventës dhe rregullit 74§2 të rregullores së Gjykatës, opinioni pjesërisht dakordësues dhe pjesërisht mospajtues i gjyqtarit Lemmens i është bashkëngjitur këtij vendimi.

R.S.
H.B.

OPINIONI PJESËRISHT DAKORDËSUES DHE PJESËRISHT MOSPAJTUES I GJYQTARIT LEMMENS

1. Jam i lumtur të dakordësohem me gjetjen se është shkelur neni 3 i Konventës. Megjithatë, teksa shumica thekson efektet e aktit të përgjithshëm të amnistisë të vitit 2012 për procedimet penale

ndaj autorëve të krimit për aktet për të cilat kërkuesja është ankuar, unë jam i mendimit se duhet të ishte treguar më shumë vëmendje ndaj rolit të luajtur nga prokurori në këtë çështje.

Për sa u përket ankesave drejtuar në mbështetje të nenit 8, me keqardhje mund të them sa nuk mund të dakordësohem me këndvështrimin e shumicës, se ato lidhen vetëm me integritetin fizik dhe psikologjik të kërkueses. Në vijim, unë nuk jam dakord me përfundimin e shumicës, se këto ankesa nuk ia vlejnë të shqyrtohen në mënyrë të ndarë.

Pjesa procedurale e nenit 3

2. Në lidhje me pjesën procedurale të nenit 3, unë jam dakord me vlerësimin se kuadri i legjislacionit penal ka një efekt mjaftueshëm parandalues (shih paragrafin 84 të vendimit). Problemi në çështjen konkrete gjendet në zbatimin e këtij kuadri.

3. Në lidhje me tre hetimet e para, më tërheq vëmendjen mënyra se si prokurori ka trajtuar ankesat e kërkueses. kur ka pasur mundësi, në mënyrë sistematike, ai ka zgjedhur veprat me dënimet më të ulëta. Si rezultat, procedimet u ndërprenë të gjitha me justifikim se ishin pjesë e objektit të aktit të përgjithshëm të amnistisë (i cili zbatohet për veprat për të cilat dënimi ishte me burgim prej dy vjetësh ose më i ulët):

a) hetimi i parë: ankesë (vetëm) për veprën e vetëgjyqësisë (dënimi maksimal: tre muaj burg) – akuzë bazuar atë vepër (asnjë specifikim nga prokurori si një vepër më e rëndë!) – procedime të ndërprera në përputhje me rrethanat, për shkak të amnistisë së përgjithshme (shih paragrafët 18–22 të vendimit);

b) hetimi i dytë: një ankesë për veprën e vetëgjyqësisë , pas së cilës, prokurori nisi një hetim penal për veprat e shkaktimit të dëmit fizik (dënimi maksimal: dy vjet burg) dhe vetëgjyqësisë (shih më sipër) – një tjetër ankesë, *inter alia*, për veprat e kanosjes (dënimi maksimal: një vit burg), fyerjes (dënimi maksimal: një gjobë), vjedhjes (dënimi maksimal: tre vjet burg), shkatërrimit të pronës (dënimi maksimal: tre vite burg) dhe përdorimit me keqdashje të thirrjeve telefonike (dënimi maksimal: një vit burg), pas së cilës, prokurori hapi një hetim tjetër penal për përdorimin keqdashës të thirrjeve telefonike – pasi u bashkuan dy hetime, prokurori arriti në përfundimin se S.N. dhe E.N. kishin kryer veprat e dëmtimit fizik, vetëgjyqësisë dhe kërcënimit – procedime të ndërprera për shkak të amnistisë së përgjithshme – apelime nga kërkuesja, e cila u ankua se prokurori nuk kishte vijuar hetimin për veprën e vjedhjes në bashkëpunim me të tjerët (dënimi maksimal: pesë vite burg), shkatërrimin e pronës (shih më sipër), torturës (dënimi maksimal: dhjetë vjet burg) dhe izolimit me anë të kanosjes ose dhunës për njohjen e pronës (shih më sipër) – vendimi për ndërprerjen u la në fuqi nga gjykatat (shih paragrafët 23–44 të vendimit);

c) hetimi i tretë: ankesa për vjedhje (shih më sipër) – hetimi për atë vepër, por më vonë vepra u rispecifikua dhe u bë akuzë për veprën e vetëgjyqësisë (shih më sipër) – procedimet u ndërprenë, sipas rrethanave për shkak të amnistisë së përgjithshme (shih paragrafët 45–50 të vendimit).

Shumica gjykon se "nuk i takon Gjykatës të spekulojë, nëse prokurori duhej të kishte ndjekur hetimet penale mbështetur në nene të tjerë të Kodit Penal" (shih paragrafin 87 të vendimit). Për mua ky është një qëndrim i pakënaqshëm për rrethanat e çështjes. Gjykata duhej të kishte vijuar më tej dhe duhej të kishte analizuar arsyet , nëse do të kishte ndonjë të tillë, se përse prokurori as nuk u përpoq të ngrinte akuza për veprat për të cilat nuk do të zbatohej akti i përgjithshëm i amnistisë.

4. Më pas vjen hetimi i katërt. Ashtu siç shprehet shumica, "kërkuesja u përpoq të përmirësonte efektet e kundërta të cilat vinin nga dhënia e amnistisë së përgjithshme duke dorëzuar një ankesë tjetër ndaj S.N., në vitin 2014, për – midis veprave të tjera – kanosje dhe shkaktim të dëmtimit të rëndë fizik, ku ky i fundit dënohej me burg deri në dhjetë vjet" (shih paragrafin 88 të vendimit).

Megjithatë, në vend që të kapte mundësinë për të hetuar çështjen, prokurori vendosi të mos e dërgonte çështjen për gjykim "duke pasur parasysh mungesën e provave" (po aty). Këtë herë, gjykata kundërshtoi. Ajo e anuloi vendimin e prokurorit. Që prej asaj kohe, nuk është bërë asnjë përparim (shih paragrafët 51–55 të vendimit).

5. Për këtë arsye, unë mendoj se është ndjekur një rrugë shqetësuese për minimizimin e rëndësisë së fakteve, dhe në këtë mënyrë, u ndoqën penalisht vetëm veprat e lehta, ndërsa veprat e rënda, relevanca e të cilave për mua është e dukshme, nuk u ndoqën penalisht. Nuk duhet kritikuar vetëm akti i përgjithshëm i amnistisë, por edhe - çfarë është edhe më e rëndësishme – specifikimi i akteve penale nga prokurori, në një mënyrë të tillë, që ato të përfshiheshin në fushën e veprimit të aktit. Çështja është një shembull i qartë i mënyrës së si efekti parandalues i kuadrit legjislativ penal është shkatërruar plotësisht.

Neni 8

6. Në lidhje me ankesën e paraqitur nga kërkuesja, sipas nenit 8, shumica gjykon se ajo ka të bëjë me pretendimin për mosrespektim të "shtëpisë, jetës dhe pronës" së saj (shih paragrafin 91 të vendimit) dhe se në parashtrimet e saj, kërkuesja ankohej specifikisht për dështimin për të "prajtur shëndetin, jetën dhe pronën e saj" (shih paragrafin 92 të vendimit). Shumica është me mendimin se ankesa "lidhet me integritetin fizik dhe psikologjik të kërkueses", i cili mbulohet me konceptin e jetës private, sipas nenit 8 (shih paragrafin 93 të vendimit). Duke theksuar në vijim se Gjykata tashmë kishte konstatuar shkelje sipas nenit 3, shumica konstaton se nuk është e nevojshme të shqyrtohet ankesa në mënyrë të veçantë, sipas nenit 8.

7. Me respekt, unë nuk jam dakord.

Për shqyrtimin e ankesave, kërkesa, sipas formulimit në formularin e kërkesës, duhet të jetë pika e nisjes (shih *Radomilja dhe të Tjerët kundër Kroacisë* [DHM], nr. 37685/10 dhe 22768/12, §122, 20 mars 2018). Kërkuesja u ankua për dështimin e autoriteteve në mbrojtjen e jetës, shëndetit dhe të pronës së saj. Përveç ankesave në lidhje me integritetin e saj fizik dhe psikologjik, të cilin Gjykata, në mënyrë unanime, vendosi ta shqyrtonte sipas nenit 3, kishte ankesa edhe në lidhje me pamundësinë e autoriteteve për ta ndihmuar atë në garantimin e zbatimit të vendimit të Gjykatës së rrethit Vlorë, për të rrëzuar kërkesën e S.N. për rimarrjen e pronësisë së shtëpisë (shih paragrafin 11 të vendimit), dhe duke e lejuara atë, në këtë mënyrë, që të jetonte në shtëpinë e saj. Ankesë u bë edhe për dështimin në mbrojtjen e saj ndaj heqjen e objekteve të saj në shtëpi nga S.N. dhe E.N. (shih paragrafët 15 dhe 17 të vendimit).

Sipas mendimit tim, këto ankesa të tjera kanë të bëjnë me të drejtën për t'iu adresuar një gjykatë (neni 6§1), me të drejtën për respektimin e shtëpisë së kërkueses (neni 8) dhe me të drejtën për respektimin e pronës së saj (neni 1 i protokollit nr. 1).

Konstatimi i shkeljes së nenit 3 nuk konsiderohet se mbulon këto ankesa.

Më vjen keq që këto ankesa, të rispecifikuara sipas parashikimeve të përmendura të Konventës nuk iu komunikuan Qeverisë. Siç duket, kërkuesja nuk ishte në pozitën për të parashtruar kërkesat e sipërpërmendura "edhe pasi çështja iu komunikua Qeverisë" (siç përmendet nga shumica në paragrafin 95 të vendimit), përderisa palëve nuk iu kërkua të paraqisnin vërejtje për to.

Për këto arsye, mendoj se ankesat në lidhje me të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, të drejtën për respektimin e shtëpisë së kërkueses dhe të drejtën për respektimin e pronës së saj do të duhej të ishin shqyrtuar në mënyrë të veçantë, nëse do të ishte e nevojshme, pasi kjo pjesë e kërkesës t'i komunikohej Qeverisë.